



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/88 Nr. i faq/Br.str/No.pg 82

Data/Datum/Date 26 / 01 / 2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.1.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 57/25, të datës 30.5.2025, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh, si në vijim:
 - 2.1. Altin Zhuniqi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. Besmire Bytyqi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. Florida Bajraktari, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.4. Flutura Thaqi, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës;
 - 2.5. Nazmi Bellaqa, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 58/25, i datës 30.5.2025.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr. 88/26
Datë: 26.1.2026


Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit